VENDIM
Nr. 952, datë 29.12.2016

PËR SHKARKIMIN NGA DETYRA TË KRYETARIT TË BASHKISË KAVAJË, Z. ELVIS ROSHI

Në mbështetje të neneve 100 e 115, pika 1, të Kushtetutës, të shkronjës "a", të nenit 62, të ligjit nr.139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore", dhe të neneve 10, pika 1, shkronja "d", dhe 14, pika 10, të ligjit nr.138/2015, "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike", me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Shkarkimin nga detyra, për shkak të shkeljeve të rënda të ligjit, të kryetarit të Bashkisë Kavajë, z. Elvis Roshi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama